

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 14 PRILL 2022

Në rast se ka një sektor që ka degraduar me shpejtësi marramendëse, është sistemi arsimor, i cili duhet të jetë më seriozi i një kombi. Sot, ky sistem, për shkak të praktikave fund e krye korruptive, për shkak të ngritjes në drejtim të vulgut dhe injorancës, është në rënie të lirë. Është në rënie të lirë, në të gjitha ciklet. 2 vjet më parë ishin të mbyllura 620 shkolla, sot me siguri numri i tyre është edhe më i madh. Sistemi i internetit që u shtri në çdo shkollë me 25 mijë kompjuterë në total, me furnizim satelitor, sot është tërësisht rudimentar. Sot universitetet e rretheve janë në proces falimentimi dhe mbylljeje. Shkakut themelor i të gjitha këtyre është largimi masiv me një politikë antikombëtare, identike me atë që parashikonte në elaboratet e tij famëzui Vaso Çubrilloviç, të intimidimit dhe vrasjes së shpresës të shqiptarët.

Shkak tjetër themelor është përpjekja për t'u rikthyer në sistemin hatëror me selektivitetin për pranimin në universitete, përmes lëvizjes me mesatare. Shkak tjetër është degradimi total i procesit mësimor, për shkak të armatës së militantëve që ka zëvendësuar mësuesit profesionistë, me të ashtuquajturin "portal të partisë", ku largohen mësues me eksperiencë 30- 35 vjeçare dhe vendosen militantë, të cilët vetëm njohuri për arsimin nuk kanë. Shkak tjetër është ligji famëzui i arsimit të lartë, i financuar me çanta me euro nga sektori privat, që ndër të tjera rriti tarifat për studentët në universitete, duke i bërë ato disa herë më të larta se në Gjermani, Austri, Slloveni e Sllovaki dhe pothuajse në të gjitha vendet e Europës, përveç Britanisë së Madhe dhe Holandës, se sa në vendet veriore dhe kudo. Bllokimi për vite të tëra i doktoraturave në universitete dhe "alergjia e xhahilëve" ndaj doktorimit të ekspertëve në universitet tona, është një shkak tjetër madhor i degradimit me shpejtësi të arsimit. Infiltrimi i falangave të kimit në botën akademike, për të terrorizuar akademikët, përbën një ndër aktet më të shëmtuara në historinë e një vendi.

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Ju nuk e keni harruar, kur kandidati për rektor, ndonëse i njohur për bindjet e tij të majta, por një njeri që nuk mund t'ua jepte kampusin e universitetit paradhënie bandave, u ndal në mes të sheshit nga famozu Shullazi, ku iu tha: "Dorëheqjen ose kokën, ose djalin peng", në emër të Edi Ramës, sepse ai donte me çdo kusht të emëronte rektore një zonjë, me të cilën të rakordonte çdo tender për kampusin universitar. Si mund të flisni ju për universitet, për arsimin, sot këtu! Ju duhet të ulni kokën, nëse ju ka mbetur qoftë një nanogram respekti për atë proces. Nuk ka pasur ndonjëherë qeveri më joserioze dhe më shkatërrimtare në sistemin arsimor, pas qeverisë së Enver Hoxhës, se qeveria juaj! Ajo e shkatërroi arsimin me trekëndëshin dhe boshtin ideologjik, kurse ju e shkatërruat me vjedhje, me militantizmin, me selektivitetin, me ligjet e miratuara këtu, tërësisht të lobuara, me valixhe me euro, nga universitetet private. Shkoni në Gjirokastrë, shkoni në Vlorë, shkoni në Shkodër, shkoni në Korçë. Ç'po ndodh me studentët?

Studentët po i përzë Edi Rama nga Shqipëria, duke u vrarë shpresën. Është bërë shpresëvrasi më i madh i kontinentit dhe më gjerë. Për të mos folur për mbylljen e universiteteve në Peshkopi dhe në Kukës. Xhahilë dhe injorantë, që nuk lexojnë asgjë. Dhe e përsëris këtu, universiteti i Peshkopisë apo i Kukësit vërtet rankoheshin diku te vendet e njëzetmijëta, por, po në atë faqe rankimi gjeje universitete në Itali, në Francë, gjeje universitete të tilla në Kaliforni. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që kishin emrin, ato ishin shkolla të larta, të cilat u jepnin të rinjve një profesion. Dhe sipas studimeve të OECD-së, studimet më të besueshme, është faktuar se ajo praktikë është e suksesshme dhe se këta studentë që mbarojnë këto shkolla, të cilat vërtet nuk janë në standardet e universiteteve, kanë një të ardhme 2 herë, 3 herë më të sigurt se ata që nuk i ndjekin këto shkolla. Çfarë ndodhi këtu? Çfarë ndodhi në Shqipëri? Ai që pagoi, vazhdoi ta mbajë licencën e universitetit, ndërsa ai që nuk pati mundësi të paguajë, atij iu hoq licenca.

Pra, keni mbajtur një qëndrim antiarsimor. Keni luajtur me procesin që duhet të jetë procesi më serioz i një kombi, siç është procesi arsimor. Për të mos thënë pastaj që shumica nga ju s'keni punë me diploma dhe doktoratura, por edhe ato që i keni, sipas burimeve të shumta, i keni plagjiatura të vërteta. Pra, jeni hajdutë në shkencë, hajdutë në ekonomi, hajdutë në çdo gjë. Kjo është Shqipëria dhe prandaj universitetet tona vidhisen 700 vende më poshtë se të Kosovës, 3 mijë vende më poshtë se të Beogradit, Zagrebit e me radhë, në rrethin e fundit në rajon. Si mund të flisni për arsimin ju?